Shtojca 2: Formulari i Ofertës ekonomike, për procedurat e prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët nga operatori ekonomik

Shtojca 3: Listat e Çmimeve të artikujve

Shtojca 4: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 5: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Sasisë dhe Grafikut i lëvrimit

Shtojca 8: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 9: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁴

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt: **[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rast]**, nuk jemi të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontratës;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

⁴ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

[Në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët, nga operatori ekonomik plotësohet dhe paraqitet vetëm kjo Shtojcë]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

ç) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës.

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë:

1	2	3
Nr.	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Kujdes: Bazuar në parashikimet e nenit 45/2.1 të VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, kur si kriter vlerësimi përdoret “oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët”, autoriteti/enti kontraktor përllogarit çmimin bazuar në:

- a) çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date
- b) elementet fiskale;
- c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës;

Shtojca 3.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në këtë Formular duhet të plotësohen dhe t'u vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa vlerë do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	<i>6</i>
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njesi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	Afati
1.	Pjata gjelle të thella	7,000			31.12.2026
2.	Pjata të cekëta gjelle	3,500			31.12.2026
3.	Tasa supe	2,500			31.12.2026
4.	Supjere	1,500			31.12.2026
5.	Luge gjelle 9-10ml	2,000			31.12.2026
6.	Luge gjelle 4-5ml	200			31.12.2026
7.	Gota porcelani	7,000			31.12.2026
8.	Pjatanca	1,500			31.12.2026
9.	Kanistra buke	500			31.12.2026
10.	Garruzhde 10cm	50			31.12.2026
11.	Garruzhde 8cm	50			31.12.2026
12.	Tava te rrumbullakta	35			31.12.2026
13.	Tava drejtekeneshe	35			31.12.2026
14.	Tenxhere 4-5 lit me kapak	30			31.12.2026
15.	Tenxhere 12-15 lit me kapak	40			31.12.2026
16.	Tenxhere 30-35 lit me kapak	30			31.12.2026

17.	Thika kuzhine	200			31.12.2026
18.	Thika mishi	50			31.12.2026
19.	Platforme per prerje mishi	10			31.12.2026
20.	Tasa sallate	1,000			31.12.2026
21.	Kana uji	1,000			31.12.2026
22.	Kullese	50			31.12.2026
23.	Qeruese patatesh	50			31.12.2026
24.	Rrahese vezesh manuale	50			31.12.2026
25.	Shtypëse manuale për pregatitjen e puresë	20			31.12.2026
26.	Rende Djathi	50			31.12.2026
27.	Shtrydhese limoni manuale	50			31.12.2026
Çmimi total (Mallrat)					_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					
Datë _____					

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi *(nëse zbatohet)*: Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]*/Nr. Referencës në faqen e APP-së.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit/entit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 5.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Nr	Emërtimi	Specifikimet teknike	Përmasat
1	Pjata gjelle të thella	Pjata gjelle të thella, me buzë të shtrira anësore që mundësojnë mbajtjen në dorë, që lahen me dore edhe në lavastovilje, me dopjo bordure anësore për të qenë rezistente ndaj goditjeve. Të jetë 100 % porcelan, jo me përbërës qeramike, të jetë e smaltuar 2 herë sipas standarteve nderkombetare dhe/ose kombetare të shtetit ku prodhohet, mbi smaltimin e porcelanit, ose ekuivalentët e tij. Nënjesën e mbrapme të kenë stampën e fabrikës (prodhuesit). Stampa të jetë e integruar dhe e njëzuar me materialin e pjatës dhe që nuk dallohet kur preket me dorë. Pjatat të jenë të bardha, pa lule.	Diametri 21 - 23 cm, Thellësia 2-3 cm

2	Pjata të cekëta gjelle	Pjata gjelle të ceketa, me buzë të shtrira anësore që mundësojnë mbajtjen në dorë, që lahen me dore edhe në lavastovilje, me dopjo bordure anësore për të qenë rezistente ndaj goditjeve. Të jetë 100 % porcelan, jo me përbërës qeramike, të jetë e zmtuar 2 herë sipas standarteve nderkombetare dhe/ose kombetare të shtetit ku prodhohet, mbi smaltimin e porcelanit, ose ekuivalentët e tij. Në pjesën e mbrapme të kenë stampën e fabrikës (prodhuesit). Stampa të jetë e integruar dhe e njësuar me materialin e pjatës dhe që nuk dallohet kur preket me dorë. Pjatat të jenë të bardha, pa lule.	Diametri 21 - 23 cm Thellësia 1-2 cm
3	Tasa supe	Tas supe për fëmijë që lahen me dore edhe në lavastovilje Të jetë 100 % porcelan, jo me përbërës qeramike, të jetë e zmtuar 2 herë sipas standarteve nderkombetare dhe/ose kombetare të shtetit ku prodhohet, mbi smaltimin e porcelanit, ose ekuivalentët e tij. Në pjesën e mbrapme të kenë stampën e fabrikës (prodhuesit). Stampa të jetë e integruar dhe e njësuar me materialin e tasit dhe që nuk dallohet kur preket me dorë. Të jenë një ngjyresh dhe me formë të rrumbullakët, gjysëmshferike e me bazament nga poshtë.	Diametri 13 - 15 cm Thellësia 5 - 7 cm Kapacitet 350 - 400ml
4	Supjere	Supjere me kapak që lahen me dorë edhe në lavastovilje. Të jetë 100 % porcelan, jo me përbërës qeramike, të jetë e zmtuar 2 herë sipas standarteve nderkombetare dhe/ose kombetare mbi smaltimin e porcelanit, ose ekuivalentët e tij.	Kapaciteti 3.0-3.5 lt
5	Luge gjelle 9-10ml	Lugë gjelle për fëmijë. Të kenë stampën dhe etiketën e fabrikës (prodhuesit). Stampa e prodhuesit dhe treguesi i materialit "Inox 18/10" të jenë stampuar me relief. Shpeshtesia e inoksit të mos jete me I vogël se 1.8 mm dhe jo me i madh se 2 mm.	Madhësia mesatare 9-10 ml
6	Luge gjelle 4-5ml	Lugë gjelle për fëmijë. Të kenë stampën dhe etiketën e fabrikës (prodhuesit). Stampa e prodhuesit dhe treguesi i materialit "Inox 18/10" të jenë stampuar me relief. Shpeshtesia e inoksit të mos jete me i vogël se 1.8 mm dhe jo me i madh se 2 mm.	Madhësia mesatare 4-5 ml
7	Gota porcelani	Gota porcelani me bisht, pa dizeno që lahen me dore edhe në lavastovilje. Të jetë 100 % porcelan, jo me përbërës qeramike, të jetë e smaltuar 2 herë sipas standarteve nderkombetare ose kombetare mbi smaltimin e porcelanit, ose ekuivalentët e tij. Në pjesën e mbrapme të kenë stampën e fabrikës (prodhuesit).	Kapaciteti 200-300 ml Diametri 8-9 cm Thellësi 10-11 cm

8	Pjatanca	Pjatanca për shërbimin e frutave dhe sallatave që lahen me dore edhe në lavastovilje. Të jetë 100 % porcelan, jo me përbërës qeramike, të jetë e smaltuar 2 herë sipas standarteve nderkombetare ose kombetare mbi smaltimin e porcelanit, ose ekuivalentët e tij. Në pjesën e mbrapme të kenë stampën e fabrikës (prodhuesit). Stampa të jetë e integruar dhe e njësuar me materialin e pjatancës dhe që nuk dallohet kur preket me dorë.	Përmasat 30-33 x 15-20 cm Thellësi 2.5-3.5 cm
9	Kanistra buke	Kanistra me forme të rrumbullakët për shpërndarjen e bukës. Materiali i përbërë me thurrje fije "ratan".	Diametri 20-25 cm; Lartësi 8-10 cm
10	Garruzhde 10cm	Garuzhde gjelle. Të kenë stampën dhe etiketën e fabrikës (prodhuesit). Materiali Inox 18/10	Diametër 10 cm. Kapaciteti 0.25 lit
11	Garruzhde 8cm	Garuzhde gjelle. Të kenë stampën dhe etiketën e fabrikës (prodhuesit). Materiali Inox 18/10	Diametër 8 cm. Kapaciteti 0.12 lit.
12	Tava të rrumbullakta	Tava pjekje të rrumbullakëta. Të kenë stampën dhe etiketën e fabrikës (prodhuesit). Materiali Inox 18/10.	Diametër 38-42 cm. Thellësi 6-7 cm
13	Tava drejtekendesh	Tave pjekje drejtekëndëshe. Të kenë stampën dhe etiketën e fabrikës (prodhuesit). Materiali Inox 18/10.	Dimensionet: 53 x 32.5 x 6.5 cm Lartësi GN 1/1 sipas standartit EN 631 Kapaciteti 8.8 Lit.
14	Tenxhere 4-5 lit me kapak	Tenxhere inoksi me kapak me kapacitet 4-5 litër. Të kenë stampën dhe etiketën e fabrikës (prodhuesit). Të kenë dy doreza të stampuara të sistemit profesional. Kapaku material Inox 18/C	Diametër 18-20 cm; Thellësi 18-20 cm; Kapaciteti 4-5 lit
15	Tenxhere 12-15 lit me kapak	Tenxhere inoksi me kapak me kapacitet 12-15 litër. Të kenë stampën dhe etiketën e fabrikës (prodhuesit). Të kenë dy doreza të stampuara të sistemit profesional. Kapaku material Inox 18/C	Diametër 28-30 cm. Thellësi 16-20 cm. Kapaciteti 12-15 lit.
16	Tenxhere 30-35 lit me kapak	Tenxhere inoksi me kapak me kapacitet 30-35 litër. Të kenë stampën dhe etiketën e fabrikës (prodhuesit). Të kenë dy doreza të stampuara të sistemit profesional. Kapaku material Inox 18/C	Diametër 35-40 cm. Thellësi 35-40cm Kapaciteti 30-35 lit.
17	Thika kuzhine	Thika të thjeshta kuzhine, me bisht plastik të derdhur, të forta që të mos shpëputen. Të kenë të stampuar në tehun e thikës stampën dhe etiketën e fabrikës (prodhuesit)	Me përmasa standarte; Gjatësia e tehut 10-11 cm
18	Thika mishi	Thika me bisht plastik të derdhur, të forta që të mos shpëputen. Të kenë të stampuar në tehun e thikës stampën e prodhuesit. Materiali i tehut inox. Të jenë për përdorim profesional.	Me përmasa mesatare. Gjatësia e tehut 18-20 cm
19	Platforme për prerje mishi	Bazament përpërje mishi, material polietilen, që nuk mban erë. Të jetë higjienik dhe jo toksikues. Ngjyra e bardhë. Të jetë i pajisur me kembe të vogla silikonit kundër rreshqitjes.	Përmasat cm 25-30 x 35-40. Trashësia jo më pak se 2 cm

20	Tasa sallate	Tasa qelqi për sallatë. Të jenë të mbivendosshme. Të kenë etiketën dhe stampën e fabrikës (prodhuesit).	Diametër 20-25 cm. Thellesi 9-10 cm
21	Kana uji	Kana qelqi me bisht për ujë.	Kapaciteti: 1.5-2 litërshe
22	Kullese	Kullesë kuzhine materiali inox. Të ketë etiketën, stampën e fabrikës (prodhuesit)	Diametër cm 24-28. Thellesi 11-12 cm
23	Qeruese patatesh	Qëruese patatesh. E gjitha material inoks 18/10.	Standarde
24	Rrahese vezesh manuale	Rrahëse vezesh me 8 fije inoks 18/10. Të jetë e pajisur me bisht inoks për kapje të mirë.	Gjatësia 25-30 cm
25	Shtypëse manuale për përgatitjen e puresë	Shtypese manuale patatesh për përgatitje pureje, Materiali: metal/Inox ose alumini. me krah të gjatë që mundëson shtypjen me lehtësi të patateve për përgatitjen e puresë.	Diametri i shtypses ø 9-10 cm; Gjatesi e krahut 30-35 cm
26	Rende Djathi	Rende, e gjitha material inoksi për grirje djathi me 4 faqe	Permasat e bazamentit Gjatësi 8-10cm Gjerësi 6-8 cm Lartësi 20-25 cm
27	Shtydhese limoni manuale	Shtydhëse agrumesh plastike, me gotë plastike. Lahet edhe në lavastovilje. E ambalzhuar dhe mbi ambalazh të jetë përcaktuar të dhënat e prodhuesit.	Përmasat: Diametri i gotës 10-12 cm; Lartësia totale e shtydhëses 10-12 cm

***Përmasat e artikujve të mësipërm mund të kenë një marzh gabimi deri në 5%.**

Argumentim për hartimin e specifikimeve teknike:

Hartimi i specifikimeve teknike është kryer në përputhje me kërkesat specifike që duhet të plotësojnë materialet dhe enët e kuzhinës, në raport me qëllimin për të cilin ato do të shërbejnë në çerdhe dhe kopshte.

Specifikimet teknike të enëve të kuzhinës janë përshkruar qartë në raport me arsyet e përdorimit të tyre, duke cilësuar materialin nga i cili përbehet secili prej objekteve si dhe parametrat e tyre.

Në qoftë se do t'i gruponim materialet e kuzhinës, në këndvështrimin e materialit përbërës të tyre, do të kishim dy grupime kryesore që janë materialet e porcelanit dhe materialet e inoksit. Ndërsa në grupimin e tretë përfshihen materialet ndihmëse në funksion të procesit të gatimit, shërbimit, apo mirëmbajtjes së kuzhinës.

Përsa i përket grupimit të materialeve të porcelanit, për hartimin e specifikimeve teknike të tyre është patur parasysh që specifikimet teknike të sigurojnë produkte cilësore, me teknologji relativisht të lartë përpunimi të porcelanit. Për produktet prej porcelain është kërkuar që “Të jetë

100 % porcelan, jo me përbërës qeramike, të jetë e zmalluar 2 herë sipas standarteve nderkombetare ose kombetare mbi smaltimin e porcelanit, ose ekuivalentët”. Kjo kërkesë është e rëndësishme sepse këto produkte duhet të garantojnë cilësi dhe standard për vetë faktin se ato do të jenë në përdorim për tju shërbyer fëmijëve të grupmoshave nga 6 muaj deri në 6 vjeç. Ky përcaktim konsiston në vetë karakteristikat teknike të produkteve me material 100% porcelan, të cilat janë të zmalluar dy herë, material dhe proces i cili siguron mbrojtje të sipërfaqes së produkteve nga sulmet kimike dhe dëmtimet fizike, për të garantuar karaktersistikat strukturore të nënshtresës por edhe për të përmirësuar pamjen e produktit. Në lidhje me kërkesën për stampimin e markës në enë lidhet me sigurimin e AK që ena është prodhim origjinal dhe lidhet me skedën teknike konkrete të depozituar në SPE.

Prodhimet e porcelanit nëse stampohen pas prodhimit, krijojnë relief dhe tregojnë që stampa nuk është vënë gjatë procesit të prodhimit. Kjo krijon riskun që produktet e ofruara të mbartin me vete mundësinë e produkteve joorigjinale, rrjedhimisht do të përbënin burim rreziku për shëndetin e fëmijëve 6 muaj deri në 6 vjeç. Kjo garantaon që produktet e porcelanit garantojnë cilësi dhe jetëgjatësi maksimale.

Produktet e inoxit sikurse është përcaktuar në specifikimet teknike do të sigurojë garanci në përdorim nga ndikimet kimike, dëmtimet fizike të sipërfaqes së tyre por do të sigurojë edhe një jetëgjatësi më të madhe të tyre në përdorim.

Në grup artikujt me material inoxi, kryesisht është kërkuar që ato të jenë prodhuar me material inox 18/10. Ky material është materiali më rezistent ndaj gërvishtjeve, çarjeve, dëmtimeve të tjera dhe defekteve sipërfaqësore, dhe për më tepër, ajo që është më e rëndësishme, ky material garanton rezistencën ndaj oksidimit. Stampimi në këto materiale duhet të jetë me relief, i realizuar në procesin e prodhimit të produktit, duke e konsideruar të vetmin stampim origjinal nga vet prodhuesi.

Përsa i përket artikujve të tjerë, të cilat janë material ndihmëse në funksion të procesit të gatimit, shërbimit, apo mirëmbajtjes së kuzhinës, specifikimet teknike të tyre janë hartuar në përputhje me rolin që ato luajnë. Përshkrimi i produkteve të kërkuara dhe specifikimet e tyre janë hartuar në përputhje me nevojat e kuzhinave të çerdheve dhe kopshteve, duke patur parasysh procesin e gatimit në zbatim të menusë së miratuar.

Për përcaktimin e përmasave orientuese të secilit produkt, është patur parasysh natyra e funksionimit të produkteve në procesin e përgatitjes për gatim, procesin e gatimit si dhe procesin e shërbimit të ofrimit të ushqimit të fëmijët. Sjellim në vëmendje se ka çerdhe dhe kopshte ku gatuhet për 30 fëmijë në ditë dhe çerdhe dhe kopshte ku gatuhet për 100 fëmijë në ditë.

Për të gjithë artikujt e kërkuar janë përcaktuar përmasat e tyre orientuese, me tolerancat e nevojshme, të cilat nuk ndikojnë në procesin e punës që ato kryejnë.

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr	Emërtimi	Njësia	Sasia	Periudha e dorëzimit
1	Pjata gjelle të thella	Copë	7,000	Nga nënshkrimi i kontratës deri në datën 30.10.2026
2	Pjata të cekëta gjelle	Copë	3,500	
3	Tasa supe	Copë	2,500	
4	Supjere	Copë	1,500	
5	Luge gjelle 9-10ml	Copë	2,000	Nga nënshkrimi i kontratës deri në datën 30.10.2026
6	Luge gjelle 4-5ml	Copë	200	
7	Gota porcelani	Copë	7,000	Nga nënshkrimi i kontratës deri në datën 30.10.2026
8	Pjatanca	Copë	1,500	
9	Kanistra buke	Copë	500	Nga nënshkrimi i kontratës deri në datën 30.11.2026
10	Garruzhde 10cm	Copë	50	Nga nënshkrimi i kontratës deri në datën 30.10.2026
11	Garruzhde 8cm	Copë	50	
12	Tava te rrumbullakta	Copë	35	
13	Tava drejtekesdeshe	Copë	35	
14	Tenxhere 4-5 lit me kapak	Copë	30	
15	Tenxhere 12-15 lit me kapak	Copë	40	
16	Tenxhere 30-35 lit me kapak	Copë	30	
17	Thika kuzhine	Copë	200	
18	Thika mishi	Copë	50	
19	Platforme per prerje mishi	Copë	10	Nga nënshkrimi i kontratës deri në datën 15.11.2026
20	Tasa sallate	Copë	1,000	
21	Kana uji	Copë	1,000	
22	Kullese	Copë	50	
23	Qeruese patatesh	Copë	50	
24	Rrahese vezesh manuale	Copë	50	
25	Shtypëse manuale për pregatitjen e puresë	Copë	20	
26	Rende Djathi	cope	50	
27	Shtrydhese limoni manuale	cope	50	

Afatet e lëvrim:

Afati i lëvrim të mallrave do të jetë që nga data e lidhjes së kontratës deri në datën 30.11.2026.

Mënyra e Lëvrim:

- Malli do të lëvrohet çdo ditë të javës nga e Hëna në të Premte.
- Dita e Shtunë, e Diel si dhe festat zyrtare janë pushim.
- Sasia e mallit që do të lëvrohet, do të kërkohet nga Autoriteti Kontraktor sipas grafikut të lëvrim të mësipërm.

Kushtet e lëvrim:

- Mallrat do të lëvrohen me automjetet e Subjektit Kontraktor në magazinën e Autoriteti Kontraktor.
- Në momentin e lëvrim të mallrave pranë magazinës së Autoriteti Kontraktor duhet të jetë i pranishëm një përfaqësues i Subjektit Kontraktor ose një person i autorizuar prej tij. Prania e përfaqësuesit të sipërshtuar përbën kusht për marrjen e mallit në dorëzim nga Autoriteti Kontraktor.

Shtojca 8.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

(Të plotësohet çdo nënseksion i Deklaratës për përmbushjen e kritereve të përgjithshme të kualifikimit, Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit, si dhe çdo seksion tjetër sipas udhëzimeve të APP);

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

(Sigurimi i Ofertës duhet të jetë i vlefshëm nga data e zhvillimit të procedurës përgjatë gjithë afatit të vlefshmërisë së ofertës sipas seksionit 3, pika 3.2 të Njoftimit të kontratës (ose 150 ditë nga data e hapjes së procedurës)

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetim nga organet tatimore, për xhiron vjetore për 3 vitet e fundit financiare, 2023, 2024, 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e fondi limit.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori Ekonomik duhet të paraqese deshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit.

- Operatori ekonomik për të vertetuar përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- Operatori Ekonomik për të vertetuar përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën SSH EN ISO 9001-2015 ose ekuivalente me të, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësive, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme, e lëshuar nga një organ i akredituar.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vetdeklarimin sipas shtojcës 9 të DST, Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit, ku të deklarojë se disponon 1 mjet transporti me “masë maksimale të autorizuar” jo më pak se 3.5 ton, e cila do të përdoret për lëvizimin e mallrave objekt prokurimi, në pronësi ose në përdorim, në momentin e deklarimit si dhe përgjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës.

Operatori ekonomik i klasifikuar i pari, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimit**, duhet të paraqesë dokumentacionin që disponon **1 (një) mjet transporti** me “masë maksimale të autorizuar” jo më pak se 3.5 ton, në pronësi ose në përdorim sipas kontratës noteriale, të vertetuar me:

- leje qarkullimi,
 - sigurancë (TPL)
 - certifikatë e kontrollit teknik
- Në rastin kur automjeti është me qera, të paraqesë kontratën noteriale përkatëse si dhe dokumentat e kërkuara të automjetit.

- Në rast se automjeti do të jetë me masë mbartëse më të madhe se 1.5 ton OE duhet të paraqesë edhe licencë transporti (për vete apo për të tretë kur automjeti është në përdorim) sipas parashikimeve të VKM nr. 325 datë 19.03.2008, “Për miratimin e rregullave për pranimin në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor të mallrave dhe të udhëtarëve, si dhe përnjohjen e dokumenteve zyrtare, të caktuara për këta operatorë”, i ndryshuar

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë **skedat teknike**.

Të dhënat teknike të përcaktuar në skedën teknike duhet të jenë në përputhshmëri të plotë me specifikimet teknike të kërkuara.

2.3.5 Ditën e hapjes së ofertave, operatorët ekonomikë pjesmarrës duhet të paraqesin nga një mostër për artikujt e mëposhtëm të kërkuar sipas specifikimeve teknike të Autoritetit Kontraktor.

1	Pjata gjelle të thella
2	Tasa supe
3	Supjere
4	Luge gjelle 9-10ml
5	Gota porcelani
6	Garruzhde 10cm
7	Tava drejtekendeshe
8	Tenxhere 12-15 lit me kapak

Mostrat e kërkuara do paraqiten në datën dhe orën e hapjes së ofertave, **pranë DPÇK me adresë Rr. e Barrikadave, Çerdhja nr.1 Tirane**.

Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë e cila të përmbajë elementet: **mostër “emri i artikullit”, datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik**.

Mungesa e mostres është kusht skualifikues.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Në rastin e Operatorëve Ekonomik të huaj i gjithë dokumentacioni duhet të paraqitet, i noterizuar dhe i certifikuar me vulë “Apostile”.

Për vendet që e kanë ratifikuar Konventën e Hagës, datë 05.10.1961 për “Heqjen e kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumentave zyrtare të huaj”, dokumentet e lëshuara duhet të përmbajnë vulën apostile në përputhje me ligjin nr. 9060, datë 8.5.2003 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për heqjen e kërkesës për legalizimin e dokumenteve zyrtare të huaja”.

Për vendet që nuk e kanë ratifikuar Konventën e Hagës, datë 05.10.1961 për "Heqjen e kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumentave zyrtare të huaj", duhet të bëhen legalizimet e ketyre dokumentave në ambasadat, konsullatat ose zyrat respektive nga vendi i origjinës. Mosparaqitja e dokumentacionit në këtë formë është kusht skualifikues.

Mosparaqitja e dokumentacionit të kërkuar, ose paraqitja e dokumentave të rreme, përbën kusht për skualifikim.

Argumentim për hartimin e kriterëve teknike të kualifikimit:

Përpërgatitjen e kërkesave për kriteret teknike të kualifikimit, komisioni ka patur parasysh garantimin e cilësisë dhe garancisë së produkteve objekt prokurimi.

- Kriteri që OE ofertues duhet të paraqesë Çertifikatën SSH EN ISO 9001:2015 ose ekuivalente të saj, të vlefshme, për tregtimin e produkteve, konsiston në kërkesën që ai duhet të zotërojë "Sistemin e menaxhimit të cilësisë" së produkteve që ai tregëton. Referuar Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit, "SSH EN ISO 9001:2015 specifikon kërkesat për njësitë e menaxhimit të cilësisë ku OE duhet të demostrojë aftësinë e tij për të ofruar produkte që plotësojnë kërkesat e AK dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative, si dhe ka për qëllim të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit ndaj klientit dhe të kërkesave të zbatueshme ligjore dhe rregullative".
- Kriteri që OE ofertues duhet të disponojë një automjet transporti me "masë maksimale të autorizuar" jo më pak se 3.5 ton, për transportin e mallarve objekt prokurimi, është në funksion të zbatimit të kontratës. Gjatë zbatimit të kontratës, OE fitues në bazë të grafikut të lëvrimit, do të transportojë me automjetet e veta mallrat e kërkuar, në magazinën e DPÇK. Kapaciteti i automjetit të kërkuar është vendosur duke patur parasysh sasinë e konsiderueshme të produkteve të kërkuara, peshën dhe volumin e tyre, në raport me grafikun e lëvrimit të përcaktuar.
Licenca në rastet kur masa mbartëse e automjetit është më e madhe se 1.5 ton është kërkuar referuar VKM nr. 325 datë 19.03.2008, "Për miratimin e rregullave për pranimin në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor të mallrave dhe të udhëtarëve, si dhe për njohjen e dokumenteve zyrtare, të caktuara për këta operatorë", i ndryshuar, si dhe Udhëzimit nr.15 datë 24.07.2007.
- Kriteri që OE ofertues duhet të paraqesë skedat teknike të produkteve të paraqitura, i shërben AK për të verifikuar plotësimin e specifikimeve teknike të përcaktuara për secilin produkt. Konkretisht nëpërmjet skedës teknike AK mund të sigurohet për materialin e artikullit, prodhuesin dhe të bëjë lidhjen e tyre me mostrën e depozituar ditën e hapjes së tenderit.
- Kriteri i vendosur për paraqitjen e mostrave vetëm për disa prej artikujve kryesorë, duke u nisur nga natyra e produkteve (produkte porcelain dhe produkte inoksi), si dhe për të garantuar kapacitetin, volumin dhe përmasat e disa prej artikujve të veçantë, duke qënë se janë artikuj që përdoren për fëmijë.

Argumentim mbi hartimin e Fondit Limit:

Fondi limit është përcaktuar referuar:

- Informacionit për llogaritjen e sasisë së planifikuar për këto artikuj, për çerdhet dhe kopshtet publike të Bashkisë Tiranë për Vitin 2026, i cili është hartuar si më poshtë:

Sasia e nevojshme për blerje për vitin 2026 është llogaritur duke patur parasysh furnizimet e mëparshme, konsumin e përafërt real të këtyre produkteve gjatë vitit 2025, në çerdhe dhe kopshte në raport me normativat e miratuara, gjëndjen aktuale të magazinës si dhe parashikimin për shtimin e numrit të çerdheve dhe kopshteve të reja duke iu referuar informacionit (me e-mail zyrtar) i datës 05.11.2025, të Drejtorisë së Buxhetit, Bashkia Tiranë, ku parashikohen Investime në vazhdim, planifikuar për tu ndërtuar dhe hapur kopshte dhe çerdhe të cilat janë pjesë e buxhetit të vitit 2025 dhe do të vijojnë në vitin 2026 për respektivisht K&Ç në Nj. nr.9 me kapacitet 350 fëmijë, K&Ç në Lagjen nr.14 me kapacitet 400 fëmijë, K&Ç në Nj. nr. 1 me kapacitet 220 fëmijë si dhe hapjen e kopshtit të ri në Farkë me kapacitet 120 fëmijë. Pra një total prej 1090 fëmijë.

Thëksojmë se lloji dhe natyra e produkteve të kërkuara për blerje është në funksion të ruajtjes dhe rritjes së performacës në procesin e gatimit dhe servirjes së ushqimit në Kopshte dhe Çerdhe në zbatim të menuesë së miratuar.

- Proçes – Verbalit të Testimit të Tregut, bashkëlidhur ofertat e OE që operojnë në treg për këtë objekt prokurimi.
- Fondit të miratuar nga Bashkia Tiranë.

Shtojca 9.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
_____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ---

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT – i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

• Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë (Emër, atësi, amësi, mbiemër, datëlindja, vendlindja, Nr. ID) :
etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv). <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____

Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së. Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

